



e Rahovecit

Rahoveci rikthen kujtesën e marsit të përgjakur, duke përkujtuar me dhimbje viktimat e masakrave të kryera ndaj civilëve shqiptarë gjatë luftës në Kosovë

Më 25 mars, në Brestoc u vranë 49 martirë, në Fortesë 68 civilë, ndërsa në Celinë 75 civilë dhe 7 mysafirë. Një ditë më pas, në Krushë të Madhe u vranë 242 persona, ndërsa 64 mbeten ende të pagjetur.

Masakrat vazhduan më 30 mars, ku në Retijë u vranë 17 martirë dhe 3 dëshmorë, ndërsa në Optrushë 27 civilë.

Këto ngjarje mbeten ndër plagët më të rënda të Rahovecit, duke u kujtuar me nderim dhe kërkesë për drejtësi.



Komuna e Rahovecit përfundon ndërtimin e sistemeve bioseptike për përmirësimin e kushteve sanitare dhe mbrojtjen e mjedisit

Komuna e Rahovec ka përfunduar ndërtimin dhe instalimin e sistemeve bioseptike në gjashtë vendbanime rurale, në kuadër të projektit “Be Clean, Be Green”, të financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti u realizua në partneritet me Komunën e Haraqinës dhe organizatat Green Art Center dhe CUIC, duke përfshirë Pataqanin e Epërm, Retijën, Polluzhën, Pataqanin e Poshtëm, Pastaselin dhe një zonë në Rahovec. Rreth 3,500 banorë përfitojnë nga ky investim, i cili ka përmirësuar ndjeshëm kushtet sanitare, ka reduktuar ndotjen dhe ka rritur mbrojtjen e mjedisit. Projekti kontribuon gjithashtu në arritjen e objektivave për ujë të pastër dhe kanalizim të qëndrueshëm.

